



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 59, Datë 15.03.2018

MBI

MIRATIMIN E KËRKESËS SË OST SH.A. PËR SHTYRJEN E AFATIT TË PIKËS 2 TË VENDIMIT TË ERE NR. 43 DATË 15.03.2017 MBI MIRATIMIN PËRFUNDIMTAR TË CERTIFIKIMIT TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE OST SH.A. NË PËRPUTHJE ME NENIN 54, PIKA 6, TË LIGJIT NR. 43/2015, “PËR SEKTORIN E ENERJISË ELEKTRIKE” DHE NENIN 9, PIKA 6, TË DIREKTIVËS 72/2009 EC MBAS MARRJES SË OPINIONIT TË SEKRETARIATIT TË KOMUNITETIT TË ENERJISË

Në mbështetje të nenit 3, pika 8 dhe neneve 16; 54 dhe 58, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 53 të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; neneve 3; 6; 8 dhe 10 të “Rregullave për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 154 datë 11.12.2015, të bordit të ERE-s, nenit 8 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, shkresave nr. 575/1 Prot., datë 13.02.2018 dhe nr. 2019 Prot., datë 12.03.2018, të OST sh.a, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 15.03.2018, mbasi shqyrtoi relacionin dhe informacionin shtesë të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi kërkesën e OST sh.a., për shtyrjen e afatit të pikës 2 të vendimit të ERE nr. 43, datë 15.03.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE me vendimin nr. 43, datë 15.03.2017, miratoi certifikimin përfundimtar të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”.
- Në pikën 2 të këtij vendimi është vendosur që :
 - Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për qëllime të implementimit të parashikimeve të nenit 8, pika 2, gërmat “c”, “f” dhe “l”, dhe “p”, të “Rregullores për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit për energjinë elektrike”, OST sh.a., të paraqesë në ERE dëshmi që tregojnë garancinë në lidhje me:
 - a. Pavarësinë e audituesit financiar. Audituesi financiar i Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike duhet të jetë i pavarur, në kuptimin që audituesi financiar nuk mund të jetë i njëjti subjekt që kryen auditimin e ndërmarrjeve/sipërmarrjeve që kryejnë ndonjë nga

veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike. Në lidhje me këtë çështje, OST sh.a. duhet t'i kërkojë Asamblesë së Përgjithshme (MZHETS) sigurimin e shmangies së emërimeve të Audituesve financiarë të njëjtë.

- b. Mos-transferimi i stafit. Mos-transferimi i stafit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike të ndërmarrjet/sipërmarrjet që kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike, dhe në lidhje me qëllimin për të vendosur detyrimin që një kategori e caktuar punonjësish nuk do të mund të punojë pranë kompanive të tjera konkurrense për 1 vit, OST sh.a do të rishikojë aktet aktuale dhe do të përpunojë rregulla të reja për marrëdhëniet e punës që sigurojnë përmbushjen e këtij kushti për një periudhë 1-vjeçare, dhe kompensimin financiar të punonjësit ndaj të cilit zbatohet ndalimi i transferimit.
 - c. Ndarja e Operatorit të Tregut. Për realizimin e këtij qëllimi, OST sh.a. duhet të marrë masat paraprake dhe të bashkëpunojë brenda kompetencave të saj për realizimin e detyrimeve ligjore të përcaktuara në ligj, për sigurimin e përmbushjes së detyrimit për ndarjen financiare dhe ligjore të Operatorit të Tregut, siç është parashikuar në nenin 57/2 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", në përputhje me rregullat e tregut të miratuara nga ERE dhe në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave për ndarjen e Operatorit të Tregut.
 - d. Bashkëpunimin ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve nëkuadrin ligjor dhe transferimi i kompetencave tek Ministria e Ekonomisë. Për përmbushjen e këtij detyrimi, OST sh.a. do t'i paraqesë ERE-s provat dokumentare që ndryshimet ligjore dhe nënligjore të nevojshme që lidhen me transferimin e kompetencave të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë tek aksionari i OST sh.a., Ministria e Ekonomisë, kanë ndodhur dhe janë efektive.
 - e. Programi i Pajtueshmërisë dhe Zyrtari i Pajtueshmërisë. Për realizimin e këtij objekti, OST sh.a. duhet që, jo më vonë se 3 muaj pas miratimit të Vendimit të Certifikimit, të caktojë Zyrtarin e Pajtueshmërisë subjekt i miratimit nga ERE, si dhe duhet që të hartojë dhe t'i dorëzojë ERE-s Programin e Pajtueshmërisë jo më vonë se 6 muaj nga caktimi i Zyrtarit të Pajtueshmërisë, konform përcaktimeve të nenit 21 të Direktivës së Energjisë Elektrike dhe nenit 14 të "Rregullores për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit për energjinë elektrike"
- OST sh.a me shkresën nr. 575/1 Prot., datë 13.02.2018 i është drejtuar ERE në përgjigje të kërkesës sonë nr. 61 Prot, datë 17.01.2018 për informacion, duke sqaruar që:

- OST sh.a. ka ndjekur dhe vazhdon të ndjekë të gjithë procedurat dhe ka marrë e vijon të marrë të gjitha masat që janë në kompetencë të saj, me qëllim realizimin e ndarjes së OST dhe përmbushjen e kushteve të përcaktuara në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE nr. 43, datë 15.03.2017.
 - OST ka nisur procedurën me sindikatën e pavarur të punonjësve të OST sh.a. për amendimin e kontratës kolektive të punës dhe reflektimin e detyrimeve të përcaktuara në pikën 2 të vendimit nr. 43, datë 15.03.2017 të Bordit të ERE, për mostransferimin e stafit.
 - Lidhur me ndarjen e Operatorit të Tregut, bën me dije se nga MIE është ndërmarrë një iniciativë ligjore me qëllim që të pasqyrojë në Ligjin nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë elektrike” ndryshimet e nevojshme për krijimin dhe funksionimin e Bursës Shqiptare të Energjisë. Në Fletoren Zyrtare nr .32, datë 09.03.2018, është botuar ligji nr. 7/2018, datë 15.02.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”. Me miratimin e këtyre ndryshimeve do të konkretizohet edhe ndarja e plotë e Operatorit të Tregut nga Operatorit i Sistemit të Transmetimit.
 - Lidhur me miratimin e programit të pajtueshmërisë sqarojmë që OST ka përcjellë në ERE kërkesën për miratimin e programit të pajtueshmërisë dhe Bordi i ERE me vendimin nr. 46, datë 07.03.2018, ka vendosur për fillimin e procedurës për miratimin e programit të pajtueshmërisë së OST sh.a.
- Në vijim të raportimit sa më sipër, për shkak të rrethanave të cilat siç spjeguar nuk varen nga vullneti i OST sh.a për të zbatuar parashikimet e vendimit të ERE nr. 43, datë 15.03.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, OST i është drejtuar ERE me kërkesën për shtyrjen me 1 vit të afatit të përmbushjes të kushteve të parashikuara në pikën 2 të vendimit të ERE nr. 43 datë 15.03.2017.
 - Kërkesa e OST sh.a është depozituar në ERE me shkresat nr. 575/1 Prot., datë 13.02.2018 dhe nr. 2019 Prot., datë 12.03.2018, dhe duke marrë në konsideratë që afati i vendosur në vendimin e Bordit të ERE nr. 43 datë 15.03.2017 plotësohet në 15.03.2018, shqyrtimi i kësaj kërkesë përpara përfundimit të afatit, plotëson kushtet sa më sipër në zbatim edhe të nenit 53 të Kodit të Procedurave Administrative i cili parashikon se : *“afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit”.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë kërkesën e OST sh.a për shtyrjen e afatit të zbatimit të pikës 2 të vendimit të ERE nr. 43 Datë 15.03.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54,

pika 6, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, deri në datën 15.03.2019.

2. Të përcjellë këtë vendim OST sh.a, Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë; Autoritetit të Konkurrencës dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI